

VENDIM
Nr.364, datë 1.4.2009

**PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME
PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM
TË KOMUNËS VRESHTAS TË QARKUT TË KORÇËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, brenda juridiksionit, territorial dhe administrativ të komunës Vreshtas të qarkut të Korçës, që transferohen, në pronësi ose në përdorim të kësaj komune, sipas lidhjes 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

Lista me 66 (gjashtëdhjetë e gjashtë) fletë, që i bashkëlidhet këtij vendimi, përfundon me numrin rendor 362 (treqind e gjashtëdhjetë e dy).

2. Ngarkohen Ministri i Brendshëm, kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe komuna Vreshtas për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

NUMRAT RENDORË TË PRONAVE NË LISTËN E INVENTARIT	FUSHA E PËRDORIMIT TË PRONËS	LLOJI I TRANSFERIMIT
197, 215,216,229	PRONA QË PËRDOREN PËR USHTRIMIN E FUNKSIONEVE NË FUSHËN E ADMINISTRATËS.	NË PRONËSI
1-9	PRONA QË PËRDOREN PËR REALIZIMIN E PROGRAMEVE ARSIMORE.	NË PRONËSI
10-18	PRONA QË PËRDOREN PËR REALIZIMIN E VEPRIMTARIVE SOCIAL-KULTURORE E SPORTIVE.	NË PRONËSI
19-22 (DUKE PËRJASHTUAR DHOMËN E PRIVATIZUAR)	PRONA QË PËRDOREN PËR USHTRIMIN E FUNKSIONEVE NË FUSHËN E SHËNDETËSISË.	NË PRONËSI
31-42	VARREZAT PUBLIKE	NË PRONËSI
43-86	TROJE TË LIRA DHE HAPËSIRA PUBLIKE TË PAZËNA NDËRMJET NDËRTESAVE OSE OBJEKTEVE TË ÇDO LLOJI	NË PËRDORIM
273-292	INFRASTRUKTURË (SHESHE, RRUGË VENDORE, LULISHTË DHE SHËRBIME PUBLIKE)	NË PRONËSI
293-296	PRONA QË PËRDOREN NË FUSHËN E FURNIZIMIT ME UJË.	NË PRONËSI
160-191,198-207,219-227	PRONA QË PËRDOREN PËR USHTRIMIN E FUNKSIONEVE NË FUSHËN E ZHVILLIMIT EKONOMIK.	NË PRONËSI
23-30, 87-159	PRONA QË PËRDOREN NË FUSHËN E STREHIMIT DHE TË MBROJTJES CIVILE.	NË PRONËSI
257-262	PRONA QË PËRDOREN PËR USHTRIMIN E FUNKSIONEVE NË FUSHËN E BUJQËSISË DHE TË USHQIMIT (TOKA PRODUKTIVE)	NË PËRDORIM
263-267,317,330,338,356	PRONA QË PËRDOREN PËR USHTRIMIN E FUNKSIONEVE NË FUSHËN E BUJQËSISË DHE TË USHQIMIT (KANALE TË TRETA DHE TOKA JO PRODUKTIVE).	NË PRONËSI